



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 23.15.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e ekipit Selvete Foniqi dhe Anëtareve Shefkije Beka dhe Adelina Selmani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
5 Qeverisja e mirë.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	18
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	21
Shtojca III: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 25/04/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:



Përgjigja e Kryesuesit të Bordit

Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Ne kemi analizuar veprimtarinë e ZRRE-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Bordit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e

pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ZRRE-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ZRRE kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Në kontekst të PFV-ve, të të arkëtueshmet kemi vërejtur që janë shpalosur në vlerë të saktë por që te kolona e vitit 2017 janë prezantuar vetëm të arkëtueshmet e vitit aktual. Me qenë se janë shpalosur në vlerë të saktë ne nuk do ta trajtojmë si çështje.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PFV-ve ashtu edhe të raportimit të jashtëm ishin përmbushur dhe ne nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, realizimi i të hyrave, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet dhe të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë, disa fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Në vitin 2017, ZRRE kishte një realizim të buxhetit prej 87%, e ku realizimi ishte për 11% më i ulët se në vitin paraprak.

Mangësi ishin identifikuar te planifikimi dhe shpenzimi nga kategoritë jo adekuate si dhe te menaxhimi i pasurive të cilat kërkojnë përmirësim dhe një fokus më të madh nga menaxhmenti. Po ashtu, sfidë mbetet realizimi i projekteve kapitale të planifikuara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	768,316	684,516	592,128	678,711	544,150
Granti i Qeverisë -Buxheti	768,316	684,516	592,128	678,711	544,150

Me vendim të Qeverisë², buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 83,800€. Ky zvogëlim ishte në paga dhe mëditje 25,000€ dhe investime kapitale 58,800€.

Për projektin “Pajisje të teknologjisë informative - Server” në shumë 58,800, mjetet ishin reduktuar nga Qeveria pasi që Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) nuk kishte arritur të përfundoi procedurat e prokurimit, përkundër që ZRRE kishte iniciuar kërkesën me kohë.

¹ Buxheti final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

² Me vendimin e Qeverisë nr.01/21 të datës 22/12/2017.

Në vitin 2017, ZRRE ka shpenzuar 87% të buxhetit final ose 592,128€. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	768,316	684,516	592,128	678,711	544,150
Pagat dhe Mëditjet	476,184	451,184	416,031	442,487	336,277
Mallrat dhe Shërbimet	199,332	199,332	149,256	176,577	189,001
Shërbimet komunale	22,000	22,000	18,196	17,119	18,872
Investimet Kapitale	70,800	12,000	8,645	42,528	-

Shpjegimet rreth shpenzimeve krahas buxhetit final në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte shpenzuar 92%. Fondi i mjeteve prej 35,153€ kishte mbetur i pashpenzuar nga fakti që gjatë vitit nuk ishin emëruar nga Kuvendi tre anëtarë bordi, si dhe një zyrtari që kishte lëshuar punën;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte shpenzuar 75%. Niveli i ulët i shpenzimeve në këtë kategori ishte si rezultat që disa kontrata dhe shpenzime ishin më të ulëta se planifikimet. Po ashtu, në këtë nivel ka ndikuar që disa shpenzime të planifikuara të aktiviteteve nuk kishin ndodhur si pasojë e mos kompletimit të Bordit; dhe
- Investimet kapitale ishin shpenzuar 72% në raport me buxhetin final. Megjithatë ky nivel pak i ulët justifikohet nga fakti që projekti ishte realizuar por me kosto më të ulët se ajo që ishte buxhetuar.

Nga kjo analizë vërehet se performanca e ulët buxhetore ishte kryesisht e ndikuar nga partnerët e jashtëm si Kuvendi dhe AQP-ja.

Çështja 1 - Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve

- E gjetura** “Projekti për pajisje të teknologjisë informative – Licenca” ishte buxhetuar dhe paguar me vlerë prej 8,644€ nga investimet kapitale. Këto licenca nuk janë shpenzime kapitale për nga afati dhe do të duhej të buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
- Rreziku** Klasifikimi dhe pagesa e shpenzimeve nga kategoria ekonomike jo adekuate ndikon në mbivlerësimin dhe/ose nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve. Si rrjedhojë e kësaj paraqitja e tyre në pasqyra financiare nuk është e drejtë.
- Rekomandimi 1** Kryetari i Bordit duhet të siguroj marrjen e veprimeve konkrete në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe realizohen nga kategoritë ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2017 ishin 1,412,853€, që janë më të ulëta se vitin paraprak që ishin 1,573,000€. Këto të hyra kanë të bëjnë me taksa vjetore të licencimit për gjenerim të ngrohjes, taksë vjetore e licencimit për gjenerim të energjisë elektrike, taksë për energjinë e importuar dhe taksë për shqyrtim të aplikacionit për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese. Të hyrat e mbledhura nga ZRRE deponohen në Buxhetin e Kosovës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të ZRRE-së kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 451,184€, ndërsa shpenzimet ishin 416,032€. Ato kanë të bëjnë me pagat e Bordit drejtues, stafit profesional dhe administratës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i aprovuar i të punësuarve në ZRRE ishte 33, ndërsa numri aktual në fund të vitit sipas PFV-ve ishte 29 punonjës përfshirë edhe anëtarët e Bordit. Pozitat e lira kanë të bëjnë me skadimin e mandatit të tre anëtarëve të Bordit dhe një zyrtar kishte lëshuar punën.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunali, ishte 221,232€. Prej tyre ishin shpenzuar 167,451€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me: shpenzimet e qirasë, shpenzimet për udhëtime zyrtare, shërbime tjera dhe komunali.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve dhe regjistrave kontabël vlera neto e pasurive kapitale ishte 52,457€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale ishte 31,803€, si dhe stoqeve 8,470€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës financiare Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja 2 - Dobësi në menaxhimin e pasurive

E gjetura

Në menaxhimin e pasurive kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Rregullorja për menaxhimin e pasurive kërkon që pasuritë jo kapitale dhe stoqet të regjistrohet në sistemin “e-Pasuria”. ZRRE ende nuk e ka në funksion sistemin e-Pasuria, përkundër që kishte bërë kërkesa në MAP për funksionalizimin e këtij sistemi. Në mungesë të këtij sistemi, regjistri i pasurisë me vlerë nën 1,000€ është duke u mbajtur në Excel;
- Sipas rregullores për menaxhimin e pasurive raporti i inventarizimit duhet të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që të krahasohet gjendja nga inventarizimi me gjendjen në regjistrat e pasurisë. Komisioni kishte kryer me kohë inventarizimin, mirëpo nuk ishte kryer harmonizimi i pasurive të inventarizuara me regjistrat e pasurive jo financiare; dhe
- Menaxhimi i automjeteve është e definuar me Rregulloren për përdorim të automjeteve zyrtare të ZRRE-së, e cila përcakton se për çdo udhëtim zyrtar duhet të mbahen evidencat e kilometrave të automjeteve. Ne verifikuam se për katër automjete të cilat janë në përdorim nuk ishin evidentuar kilometrat e kaluara.

Rreziku

Mangësitë e evidentuara më lartë pasqyrojnë dobësi në menaxhimin e pasurive dhe i ekspozojnë pasuritë pranë rrezikut të humbjes apo keq menaxhimit. Po ashtu, regjistrimi i pasurive jo kapitale në Excel ku ekziston mundësia e ndryshimeve në çdo kohë pa lënë ndonjë gjurmë, rritë rrezikun që informatat e prodhuara për PFV të jenë të pasakta dhe jo të plota.

Rekomandimi 2

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj mbikëqyrje aktive ndaj personelit që merret me menaxhimin e pasurive përfshirë edhe vazhdimin e përpjekjeve me MAP-in për funksionalizimin e sistemit e-Pasuria. Po ashtu, duhet siguruar mbajtja e evidencave të automjeteve dhe harmonizimi i pasurive në mes regjistrave nga inventarizimi me atë të regjistrave të pasurive.

3.7 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme kanë të bëjnë kryesisht me obligimet e debitorëve lidhur me taksën vjetore për licencim dhe taksën për energjinë e importuar. Në fund të vitit 2017 llogaritë e arkëtueshme ishin 67,580€.

Vlera e të arkëtueshmeve është mjaft e lartë, por pjesa më e madhe e kësaj vlerë prej 46,243€ i takon vitit aktual dhe rezulton nga fakti që faturimet e vitit 2017 janë të muajit nëntor-dhjetor. Pjesën tjetër prej 21,337€ e përbëjnë bilancet e bartura nga viti 2010, ku pjesa më e madhe prej 19,837€ i përket Termokosit.

ZRRE, kishte zhvilluar komunikime me Termokosin, ku një pjesë e të arkëtueshmeve ishte inkasuar, mirëpo mbetet sfida arkëtimi i plotë. Vlen të theksohet se që prej vitit 2015, ZRRE nuk e faturon Termokosin, tash pas funksionalizimit të ngrohjes me aplikimin e koogjenerimit kjo i faturohet Kosovës B, për prodhimin e energjisë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 8,054€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018, të cilat kryesisht ishin obligime të fund vitit.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e ZRRE-së për vitin 2016 ka rezultuar me pesë rekomandime. ZRRE kishte përgatitur planin e veprimit, ku kishte paraqitur detajet e aktiviteteve se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Nga pesë rekomandimet e dhëna tre ishin zbatuar, një është në proces dhe një nuk është zbatuar ende.

Kurse për vitin 2015 raporti i auditimit ka rezultuar me pesë rekomandime, prej të cilave katër ishin bartur për tu zbatuar në 2017. Nga rekomandimet e bartura, dy janë zbatuar, një është në proces dhe një nuk është zbatuar. Rekomandimi i cili nuk ishte zbatuar ka të bëjë me menaxhimin e pasurisë e cila çështje është trajtuar edhe në këtë raport të çështja 2.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

ZRRE ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vetëvlerësimin. Po ashtu ka përgatitur me kohë planin për zbatimin e rekomandimeve, si dhe ka arrit të zbatoj pjesën më të madhe të tyre.

Me gjithë progresin e realizuar në vlerësojmë që disa aspekte të qeverisjes brenda ZRRE-së kërkojnë përmirësim të mëtejshëm siç është menaxhimi dhe monitorimi i rreziqeve. Në prill të vitit 2018 ishte përgatitur regjistri i rreziqeve, me funksionalizimin e Bordit. Mbetet sfidë menaxhimi dhe monitorimi i regjistrit të rreziqeve, në periudha tremujore.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Bazuar në U/A nr.23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), ZRRE nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosja e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Procesi i raportimit të brendshëm në ZRRE funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe sipas ligjit dhe strukturës organizative. Menaxhmenti ka vendosur linja të komunikimit dhe njoftohet përmes raportimeve mujore, për aktivitetet operacionale dhe financiare të organizatës. Deri në maj 2017 takimet e Bordit janë përcjell me procesverbale, pasi që pas kësaj date me kalimin e mandatit të Kryesuesit të Bordit ai nuk ishte funksional pasi ishin vetëm dy anëtar Bordi. Bordi nuk është kompletuar deri në mars të vitit 2018.

Po ashtu, ekzistojnë edhe raportimet tremujore financiare, si dhe raportimet sipas kërkesave ligjore.

Çështja 3 - Dobësi në menaxhimin e rrezikut

E gjetura ZRRE për vitin 2017 nuk kishte hartuar regjistrin e rreziqeve siç kërkohet me rregullat e MFK-së. Me funksionalizimin e bordit, në prill 2018 ishte hartuar regjistri. Mbetet sfidë menaxhimi dhe monitorimi i rreziqeve në mënyrë aktive për sa i përket azhurnimit dhe sigurimit se janë duke u ndërmarrë veprime për të parandaluar dhe zbutur rreziqet.

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut pamundëson reagimin me kohë ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet organizata, qofshin ato nga mjedisi i brendshëm apo i jashtëm. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar rreziqet e tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi 3 Kryetari i Bordit duhet të siguroj që regjistri i rreziqeve i hartuar në 2018 të ketë një monitorim dhe azhurnim efektiv në baza tremujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë, me qëllim të parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.


Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake


Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Rekomandimet e vitit 2015	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimit lidhur me menaxhimin e pasurisë.	Po		
Qeverisja e mirë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar regjistrin e rreziqeve si operative ashtu edhe financiare si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.		Regjistri i rreziqeve ishte hartuar në prill 2018, dhe mbetet sfidë menaxhimi dhe monitorimi i këtij procesi.	
Paga dhe mëditje	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që respektohen të gjitha procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.	Po		
Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryesuesi i Bordit duhet t'i rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja keqpërdorimi.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Progresi në zbatimin e	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj një plan të rishikuar i cili përcakton afatet dhe zyrtarët përgjegjës për zbatim, si dhe të	Po		

rekomandimeve të vitit paraprak	zbatojë një proces efektiv dhe formal për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Progresi kundrejt planit duhet të rishikohet në mënyrë sistematike dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.			
Pyetësi i vetëvlerësimit	Kryesuesi i Bordit duhet t'i identifikojë shkaqet për vonesat në procesin e menaxhimit të rreziqeve dhe të sigurojë që deri më 1 tetor 2017 do të përcaktohet stafi përgjegjës dhe do të vendosen dokumentet bazë. Procesi i menaxhimit të rrezikut duhet të rishikohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti i lartë.		Regjistri i rreziqeve ishte hartuar në prill 2018, dhe mbetet sfidë menaxhimi dhe monitorimi i këtij procesi.	
Procesi i rekrutimit	Kryesuesi i Bordit duhet t'i analizojë arsyet pse kontrollet e rekrutimit nuk kanë funksionuar dhe t'i forcojë ato për të siguruar një proces të rregullt dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Proceset e rekrutimit duhet të ofrojnë bazë për konkurrencë dhe trajtim të barabartë për të siguruar përzgjedhje të stafit profesional.	Po		
Mungesa e planit për menaxhim të kontratës	Kryesuesi i Bordit t'i forcojë kontrollet e prokurimit publik dhe të sigurojë që për çdo kontratë të hartohet plani i menaxhimit të kontratës, në mënyrë që të zbatohen kërkesa ligjore.	Po		
Dobësi në menaxhimin e pasurisë	Kryesuesi i Bordit duhet t'i rishikoj kontrollet ekzistuese dhe t'i forcojë ato për të siguruar që dobësitë e identifikuara do të eliminohen deri më 1 tetor 2017. Regjistri i përgjithshëm i pasurive duhet të azhurnohet dhe raportet lidhur me pasuritë duhet të hartohen në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e rregullores.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letërkonfirmimi


ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
NR. 226/18
DATA: 05.06.18


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE


05.Qershor 2018, Prishtinë

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Arsīm Janova,

u.d Kryesues i Bordit të ZRRE-së
